

VENDIM
Nr. 858, datë 4.11.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 349, DATË 12.6.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MASAVE
MBËSHTETËSE PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA BURIMET E RINOVUESHME TË DIELLIT DHE ERËS, SI DHE TË
PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE PËR PËRFITIMIN E
TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 8, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “k”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“k) “Tarifa tavan” është tarifa tavan për procedurën konkurruese që përcaktohet nga ministri, duke u bazuar në tarifën e miratuar nga ERE për të njëjtën teknologji, llojin dhe kapacitetin e impiantit, koston e investimit të teknologjisë së ngjashme, si dhe tarifave të rezultuara në ankande për kapacitete të ngjashme në Shqipëri dhe vende të tjera.”.

b) Pas shkronjës “l”, të pikës 3, shtohen shkronjat “ll”, “m”, “n” dhe “nj”, me këtë përmbajtje:

“ll) “Kontrata për zhvillimin e projektit” është kontrata për zhvillimin e projektit, e lidhur ndërmjet ofertuesit të përzgjedhur dhe autoritetit kontraktor.

m) “Marrëveshja përfundimtare”, marrëveshja e nënshkruar nga autoriteti kontraktor, ofertuesi i përzgjedhur dhe shoqëria e projektit, që konfirmon përmbushjen e gjitha kushteve të përcaktuara në kontratën për zhvillimin e projektit dhe që e bën efektive.

n) “Procedura konkurruese me vendndodhje të përcaktuar” është procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në kërret II dhe III, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante diellore dhe/ose nga era (eolike), me vendndodhje dhe kapacitet të instaluar, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

nj) “Procedura konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar” është procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në kreun III/1, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante diellore me kapacitet të instaluar nga 5 mw deri në 10 mw dhe/ose pa kufizim kapaciteti për impiante nga era (eolike), me vendndodhje të propozuar nga ofertuesi.”.

c) Shkronja “b”, e pikës 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Në rastin e procedurës konkurruese me vendndodhje të përcaktuar, kalimin në administrim të autoritetit kontraktor të pasurive të paluajtshme për realizimin dhe shfrytëzimin e projektit dhe vënien e tyre në dispozicion të shoqërisë së projektit për të gjithë kohëzgjatjen e tij, pa pagesë.”.

2. Pas kreut III shtohet kreu III/I, me këtë përmbajtje:

“KREU III/1

**ZHVILLIMI I PROCESIT KONKURRUES PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE ME
PROCEDURË KONKURRUESE ME VENDNDODHJE TË PAPËRCAKTUAR**

1. Ministri autorizon fillimin e procesit konkurrues për përzgjedhjen e projekteve me procedurë konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar, duke përcaktuar të dhënat, si më poshtë vijon:

a) kapacitetin total, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme, që mund të ofrohet në këtë procedurë të posaçme konkurruese;

b) kapacitetin e instaluar që mund të ketë çdo projekt që do të përfitojë masat mbështetëse, të cilat, për projektet fotovoltaike nuk mund të jenë më të vogla se 5 mw dhe më të mëdha se 10 mw;

c) llojin e teknologjisë së projekteve;

ç) operatorin përgjegjës të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë;

d) dokumentet e nevojshme për zhvillimin e procesit konkurrues;

dh) kriteret e vlerësimit të ofertave;

e) kërkesat për caktimin e vendndodhjes së projektit.

3. Ministri mund të përcaktojë të organizojë procedurën konkurruese me një fazë ose me dy faza, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) në procesin me një fazë, komisioni i posaçëm harton dhe publikon të gjitha dokumentet e procedurës konkurruese në një fazë;

b) në procesin me dy faza, komisioni përcakton listën e dokumenteve për fazën e kërkesave kualifikuese, që përfshijnë kërkesat teknike dhe financiare për parakualifikimin e ofertuesve. Në fazën e dytë komisioni përcakton kërkesat për fazën e propozimit, gjatë së cilës ofertuesit e parakualifikuar në fazën e parë do të ftohen për të paraqitur propozimin e detajuar teknik dhe financiar, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga komisioni.

3. Ministri ngre komisionin e posaçëm, i cili ka këto kompetenca:

a) harton dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues për përfitimin e masave mbështetëse;

b) harton kriteret të veçanta të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 6, të kreut II;

c) harton metodologjinë e vlerësimit të ofertave, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;

ç) vlerëson ofertat e ofertuesve bazuar në kriteret e parakualifikimit, kualifikimit dhe vlerësimit të ofertës;

d) harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit;

dh) çdo funksion tjetër bazuar në parashikimet e këtij vendimi.

4. Dokumentet e procesit të posaçëm konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë, si më poshtë vijon:

a) ftesën për ofertë, e cila bëhet publike dhe publikohet së paku në Buletin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

b) udhëzuesin për pjesëmarrës në proces;

c) sigurimin e ofertës, i cili lëshohet nga një institucion bankar apo financiar i besueshëm, në vlerën dhe formatin e parashikuar në dokumentet e procesit konkurrues;

ç) afatin e vlefshmërisë së ofertës;

d) pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në proces;

dh) kriteret bazë të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit;

e) kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) afatin e paraqitjes së ofertave, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë;

f) çdo dokument tjetër që do të vlerësohet nga komisioni i posaçëm në përmbushje të kriterëve të kualifikimit;

g) detyrimin që për një procedurë konkurruese, i njëjti subjekt nuk mund të sjellë më shumë se një ofertë.

5. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë edhe që:

a) tarifa e ofertuar nga subjektet duhet të jetë në euro/mwh dhe të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet;

b) tarifa e ofertuar nga subjektet nuk duhet të jetë më e lartë se tarifa tavan e përcaktuar nga ministri.

6. Për të siguruar që ofertuesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e projektit, komisioni i posaçëm do të bazohet në kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit, në të cilat, ndër të tjera, përfshihen:

a) Kriteret ligjore:

i. në rast të bashkimit të shoqërive, ofertat e dorëzuara duhet të shoqërohen me një marrëveshje të përbashkët të ofertimit ndërmjet anëtarëve të bashkimit;

ii. vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

iii. shoqëria apo bashkimi i shoqërive, si dhe drejtuesit e shoqërisë ofertuese ose e ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin e shoqërive ofertuese nuk duhet të jenë në ndjekje penale ose të jenë dënuar me një vendim të formës së prerë.

b) Kriteret financiare:

i. çdo dokumentacion i nevojshëm që vërteton gjendjen financiare të kompanisë dhe provon aftësinë e saj financiare për të realizuar projektin, sipas dokumenteve të procesit konkurrues;

ii. pasqyrat financiare, të audituara nga audituesit e licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të depozituara në organet tatimore ose, kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, shoqëruar prej vërtetimit të licencës së audituesit.

c) Kriteret teknike:

i. shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese duhet të provojnë vetë ose me anë të një marrëdhënieje bashkëpunimi përvojë në të shkuarën për realizimin dhe/ose shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme, në përputhje me dokumentet e procesit konkurrues;

ii. në varësi të teknologjisë së përzgjedhur, modulet e paneleve diellore apo të turbinave eolike, inverterat dhe komponentët e tjerë elektrikë dhe elektromekanikë, si dhe lidhjet elektrike dhe ndërfaqësimet *software* dhe *hardware* të jenë në përputhje me kërkesat e rrjetit, si dhe të sigurojnë ofrimin e të dhënave reale metrike diellore dhe/ose eolike, lidhur me prodhimin e pritshëm vjetor të energjisë;

iii. aparaturat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga komisioni i posaçëm.

ç) Kriteria të tjera të vlerësimit të ofertës:

i. ofertuesit duhet të ofrojnë një tarifë të nivelizuar 15-vjeçare në euro/mwh, e cila do të jetë pjesë e kriterëve të vlerësimit;

ii. ofertuesit duhet që në momentin e aplikimit të kenë paraqitur dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi tokën/pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e burimit gjenerues;

iii. ofertuesi duhet të paraqesë propozimin për lidhjen me rrjetin, duke deklaruar se do të mbulojë me fondet e saj çdo kosto për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lidhjen e rrjetit deri në pikën e autorizuar nga operatori i rrjetit.

d) Kriteria për përcaktimin e vendndodhjes:

Vendndodhja e propozuar duhet të jetë në tokë të pafrytshme ose toka që janë jo të kategorizuara si të frytshme.

7. Të drejtën për të aplikuar e ka çdo shoqëri ose bashkim shoqërisht ofertuese që paguan tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues, sipas kushteve të specifikuara në dokumentet e procesit konkurrues.

8. Ofertat e ofertuesve do të vlerësohen sipas kriterëve të kualifikimit të ofertës të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, bazuar në një metodologji të vlerësimit të ofertave, të përbërë me pikë të ndara sipas secilit kriter, që është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues.

9. Metodologjia e vlerësimit të ofertave duhet të parashikojë që çmimi i ofruar nga subjektet për blerjen e energjisë të zërë së paku 50% të pikëve.

10. Për secilin prej kritereve të vlerësimit, ofertuesit duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

11. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit, sipas këtij vendimi, është më i ulët se sa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm shpall të gjithë ofertuesit që përmbushin kriteret e kualifikimit si ofertues të përzgjedhur.

12. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit është më i lartë se sa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm bën përlogaritjen e pikëve për ofertuesit dhe renditjen e tyre sipas rezultatit më të lartë, duke shpallur edhe ofertuesit e përzgjedhur.

13. Në përfundim të vlerësimit të ofertave, komisioni i posaçëm paraqet për miratim pranë ministrit raportin përfundimtar të vlerësimit.

14. Ministri autorizon negocimin dhe nënshkrimin e kontratës për zhvillimin e projektit me ofertuesit e përzgjedhur, që përmban të gjitha elementet për zbatimin e suksesshëm të projektit.

15. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të formojë një shoqëri për projektin për të hyrë në marrëveshje përfundimtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

16. Para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare, ofertuesi i përzgjedhur/shoqëria e projektit duhet të paraqesë garancinë e kontratës, sipas përcaktimeve të dokumenteve të procesit konkurrues.

17. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të garantojë respektimin e rregullave të tregut, si dhe të kërkesave teknike të rrjetit dhe balancimit të ngarkesës në Shqipëri.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe